- Është bërë vazhdim i kontratave të punëtorëve të Kompanisë të cilët kanë qenë me kohë të caktuar për gjashtë muaj dhe një vit, dhe të punëtorëve që kanë pasur kontratën e parë të punës me mundësi të vazhimit. Vazhdimi i kontratave është bërë pas vlerësimit të punëve nga ana e udhëheqësve të sektorëve përkatës.
- Me kontratë për punë dhe detyra specifike kemi të punësuar tre punëtorë.
- Tetë punëtor janë në pushim pa pages, ndërkëta tre punëtor janë nga shtatori në pushim pa pages pasi që janë në listat partive politike për Asamble Komunale konform Ligjit për zgjedhje.
- Pas shqyrtimit të lëndëve nga komisioni disiplinor dhe konstatimet të nxjerrura për punonjësit inksantet R.Hajdari dhe I.Bityqi dhe ujëinstaluesit në njësinë e Suharekës V. Jashari se kanë bërë shkelje të detyrave të punës I janë shqiptuar masa disiplinore Vërejtje me shkrim.
- Në bazë të kërkesës Nr.049 të dt.16.01.2017që ka parashtruar Rrezarta Jahaj-Kuçi, për kryerjen e praktikës në Laboratorin e KRU" Hidroregjioni Jugor" Prizren gjë që I është mundësuar kryerja e pjesës praktike prej dt.16.01.2017 deri më 16.07.2017, pas përfundimit të punës praktike Kompania i ka lëshuar Referenc për zgjuarsi dhe ndihmesën e madhe për punën e përditshme në laborator.
- Janë përgaditur "Udhëzimi për zgjidhjen e kontesteve me konsumatorë në KRU" Hidroregjioni Jugor" sh.a Prizren dhe Rregullorja për për iniciimin e procedurës përmbartimore të organi përmbartues, ", dhe pas shqyrtimit nga Bordi i Drejtorëve janë aprovuar njëzëri.
- Sipas Ligjit të Punës është përgatitur forma e kërkesës për punë jashtë orarit të cilën duhet ta arsyetoj udhëheqësi i shërbimit përkatës dhe forma e Aktvendimit I cili duhet të nënshkruhet nga

punëdhënësi për punën më të gjatë se orari i plotë i punës së të punësuarit dhe paga shtesë në përqindje të pagës bazë, në bazë të nenit 56 të Ligjit të punës Nr.03/L-212

- Sipas kërkesë së NJPMNP është raportuar për kompensime dhe bonuse në total për vitin 2016 të Bordit të Drejtorëve dhe për pagat e zyrtarëve të lartë të Kompanisë gjithsej për vitin 2016.
- Është përgaditur urdhëres për Shërbimin me Konsumatorë i Kompanisë, që ndaj konsumatorëve për të cilët është iniciuar dhe janë në procedurë përmbartimore, të njëjtit nuk do të përfitojnë falje të borxhit nga arsyeja që Ligji Nr. 05/L-043 për Faljen e Borxheve Publike nuk është më në fuqi. Me konsumatorët mundë të lidhet Kontrata – Marrëveshja për pagesën e borxhit ndaj Kompanisë me këste, por duke mos përfshirë faljen e borxhit.
- Është përgaditur vendim ku janë caktuar përfaqësuesit e Kompanisë për takime dhe konsultime me Kforin Gjerman lidhur me kontrollimin dhe pranimin teknik të rezervuarit të ujit në parcelen katastrale 7334 në Prizren e cila aktualisht është duke u shfrytëzuar nga Kfori Gjerman.
- Janë përgaditur kërkesat e Kompanisë për integrimin me KRU" Hidroregjioni Jugor" të Bashkësisë së ujrave "Lumbardhi" që aktivitetin e vet në furnizim me ujë të pijës e kryen në Fshatrat e Komunës së Prizrenit, klientë i ka qytetarët e Komunës së Prizrenit dhe integrimin me KRU" Hidroregjionin Jugor" të sistemit të ujitjes së tokave bujqësore të Prizrenit që menaxhohet nga NP" Dukagjini".

4.2 PERSONELI – korrik – shtator 2017

Muajt	Nr. i te punsuarve sipas muajve	Vende te plotësuara	Te larguar	Të pensionuar	Punë praktike
korrik	326			2	
gusht	326				
shtator	327				

NUMRI I PUNËTORËVE SIPAS NACIONALITETEVE - GJENDJA: Shtator - 2017

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A					
Nacionaliteti	Shqiptarë	Boshnjak dhe Musliman	Romë, Ashkali dhe Egjiptas	Turq	Gjithsejtë numri i punëtorëve
Numri i Punëtorëve	278	35	5	8	327
Numri i Punëtorëve në %	85.3	10.7	1.5	2.4	100

NUMRI I PUNËTORËVE NË 1000 KONSUMATORË DHE SIPAS GJINISË

GJINIA:	NR	NR. %	Nr. Në 1000 Kon.
FEMRA:	41	12.54	
MESHKUJ:	286	87.46	
TOTAL	327	100.00	

KUALIFIKIMI I PUNËTORËVE - GJENDJA: Shtator 2017

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH.A								
KUALIFIKIMI								
DHJETOR	Fakultet	Bachelor	Sk.K. e lartë	Sh. e mesme	Sh.N.E	Shkolla fillore	Pa kualifikim	Gjithsejë
Nr. i punetorëve	32	35	1	209	1	48	1	327
Kualifikimi në %	9.79	10.70	0.31	63.91	0.31	14.68	0.31	100

Raport i numrit te punetorëve për KORRIK – SHTATOR 2017 duke përfshire edhe BD dhe të ndar për njësi punuese

Muaji	Hidroregjioni Jugor	Prizren			Suharekë	Dragash	Malishevë
		Prizren	Bordi	Total			
Korrik	332	240	6	246	36	15	35
Gusht	332	239	6	245	36	16	35
Shtator	333	240	6	246	37	15	35

4.3 Raport i rasteve ne gjykata**PËRFAQËSIMI NË GJYKATA DHE ARDHJA NË TOTAL E LËNDVE NGA GJYKATAT PËR PERIUdhËN KOHORE KORRIK – SHTATOR 2017**

	Seanca përgatit ore	Seanca kryesor e	Seanca të shtyra	Shkresa te ardhura nga gjykata t
Korrik	2	1	5	13
Gusht	4	5	2	9
shtator	1	2	1	17
Totali	7	8	8	39

- Nga Gjykatat për periudhën kohore KORRIK - SHTATOR 2017, në total kanë ardhur **39 (tridhjetë e nëntë)** shkresa.
- Për **16 (gjashtëmbëdhjetë)** lëndë nga gjykatat janë marrë **Vendime** në favor të Kompanisë.
- Për **2 (dy)** lëndë Gjykata ka marrë Vendim kundër Kompanisë .
- Për **9 (nëntë)** lëndë Gjykata ka marrë Vendim për aprovim të pjesërishëm të prapësimeve të debitorëve.
- **1 (një)** Konkluzion për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm.

- **1 (një)** Konkluzion me të cilin gjykata kërkon që ne ta njoftojmë lidhur me borxhin e konsumatorit.

- **10 (dhjetë)** Ftesa për pjesëmarrje në seanca gjyqësore.

- **1 (një)** Njoftim nga Prokuroria lidhur me parashkrimin e Kallëzimit Penal ndaj NN personit.

Punët tjera nga Zyra Ligjore

Konsultimin, analizimin dhe studimin e Ligjeve, Udhëzimeve Administrative, Rregulloreve dhe materialeve tjera lidhur me përgatitjet teorike për nxjerrjen e Rregulloreve të ardhshme të cilat duhet të harmonizohen me Ligjet dhe Aktet tjera të reja;

Janë dhënë Përgjigje në Ankesa, Përgjigje në Padi, Përgjigje në Kërkesa të punëtorëve, përgjigje ndaj konsumatorëve, përgjigje ndaj institucioneve të ndryshme si dhe personave tjerë fizik për çështje të ndryshme;

Janë mbajtur 5 (Pesë) seanca të Komisionit Disiplinorë ku i kemi nxjerrë Konstatimet lidhur me rastet si dhe i kemi përgatitur Vendimet për rastet në fjalë;

Janë bërë përkthime të Konkurseve të Kompanisë nga Gjuha Shqipe në Gjuhën Boshnjake;

Pjesmarrje në Komisione për pranimin e punëtorëve në punë;

Konsumatorët e ndryshëm janë udhëzuar dhe njoftuar për procedurën përbarimore dhe hapat që të njëjtit duhet ti ndërmarrin për pagesën e borxheve që kanë ndaj Kompanisë;

Pjesmarrje në seanca gjyqësore lidhur me borxhet e konsumatorëve dhe për kontestet tjera;

PUNËT E KRYERA ME PËRMBARUESIT PRIVAT PËR TREMUJORIN E III-të KORRIK – SHTATOR 2017 NJËSIA PUNUESE NË PRIZREN

	Propozime për përbarime	Prapësime	Përgjigje në prapësime	Marrëveshje	Ankesat në gjykatën e Apelit	Përgjigje në Ankesa	Tërheqje	Të përfunduara
Korrik	26	3	3	3	/	/	1 1	4
Gusht	40	4	4	14	/	/	/	6
Shtator	38	6	6	12	/	/	1	7
Totali	104	13	13	29	/	/	2	17

- Te Përmbaruesi Privat i kemi dërguar **104 (njëqindtë e katër)** lëndë me propozim për përbarim.

- Janë parashtruar **13 (trembëdhjetë)** Prapësime nga ana e debitorëve.

- Janë dhënë **13 (trembëdhjetë)** Përgjigje në Prapësime të debitorëve.

- Janë lidhur **29 (njëzet e nëntë)** marrëveshje me Debitorë.
- I kemi pasur **2 (dy)** tërheqje të Propozimit për Përmbarrim.
- Janë përfunduar **17 (shtatëmbëdhjetë)** lëndë.

KORRIK – SHTATOR NJËSIA PUNUESE MALISHEVË

	Propozime për përmbarrime	Prapësime	Përgjigje në prapësime	Marrëveshje	Ankesat në gjykatën e Apelit	Përgjigje në Ankesa	Tërheqje	Të përfunduara
Korrik	/	/	/	7	/	/	/	2
Gusht	10	/	/	5	/	/	/	7
Shtator	11	/	/	11	/	/	/	4
Totali	21	/	/	23	/	/	/	13

- Te Përmbarruesi Privat i kemi dërguar **21 (njëzetë e një)** lëndë me propozim për përmbarrim.
- Janë lidhur **23 (njëzete tri)** marrëveshje me Debitorë.
- Janë përfunduar **13 (trembëdhjetë)** lëndë.

KORRIK – SHTATOR 2017 NJËSIA PUNUESE SUHAREKË

	Propozime për përmbarrime	Prapësime	Përgjigje në prapësime	Marrëveshje	Ankesat në gjykatën e Apelit nga Kompani	Përgjigje në Ankesa	Tërheqje	Të përfunduara
Korrik	13	2	2	/	/	/	/	/
Gusht	25	3	3	9	/	/	/	/
Shtator	23	4	4	4	3	/	/	3
Totali	61	9	9	13	3	/	/	3

- Te Përmbarruesi Privat i kemi dërguar **61 (gjashtëdhjetë e një)** lëndë me propozim për përmbarrim.
- Janë parashtruar edhe **9 (nëntë)** prapësime nga ana e debitorëve.

- Janë dhënë **9 (nëntë)** Përgjigje në Prapësime të debitorëve.
- Janë lidhur **13 (trembëdhjetë)** marrëveshje me Debitorë.
- Janë parashtruar **2 (dy)** Kërkesa për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm.
- Janë përfunduar **3 (tri)** lëndë.

KORRIK – SHTATOR 2017 NJËSIA PUNUESE DRAGASH

	Propozime për përbarime	Prapësime	Përgjigje në prapësime	Marrëveshje	Ankesat në gjykatën e Apelit nga Kompani	Përgjigje në Ankesa	Tërheqje	Të përfunduara
Korrik	/	/	/	6	/		/	/
Gusht	/	/	/	4	/	/	/	/
Shtator	/	1	1	4	/	/	/	/
Totali	/	1	1	14	/	/	/	/

- Te Përmbartuesi Privat i kemi dërguar **0 (zero)** lëndë me propozim për përbarim.
- Është parashtruar **1 (një)** Prapësim nga ana e debitorëve.
- Është dhënë **1 (një)** Përgjigje në Prapësim debitorëve.

LËNDËT TË CILAT GJINDEN NË PROCEDURË DHE TË CILAT E KËRCËNOJNË KOMPANINË

Nr.	Emri, mbiemri dhe Adresa	C. nr	Kontesti	Vlera	Vërejtje
01	Remzi Hoxha nga Zhuri, KK Prizren	C. nr. 1214/12, datë 05.03.2013	Padi -Kontest pune	Dëmshpërblimi – ende nuk është i caktuar	Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit
02	Xhezair Bajrami, KK. Dragash,	C. nr. 116/03, datë 08.05.2013	Padi për Dëmshpërblim	Dëmshpërblim në vlerë prej 25.753.52 Euro	Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit
03	Fazli Kastrati nga Njësia Punuese e Malishevës	C.nr. 286/14, datë 03.06.2015	Padi –Kontest pune	Dëmshpërblimi – ende nuk është i caktuar	Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit të Kosovës

1. C. nr. 1214/12, datë 05.03.2013, Padi për kthim në vendin e punës, dëmshpërblimi ende nuk është i caktuar, Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit në Prishtinë.

2. C. nr. 116/03, datë 08.05.2013, Padi për dëmshpërblim, dëmshpërblimi i kërkuar është në vlerë prej **25.753.52 Euro**, Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit në Prishtinë.

3. C. nr. 286/14 , datë 29.09.2014, Padi –Kontest nga marrëdhënia e punës, dëmshpërblimi ende nuk është i caktuar, Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit në Prishtinë.

Aktivite e Zyrarit për Siguri dhe Shendetin në Punë TM-2 / 2017

- Gjatë periudhes të TM-3 jan bërë kontrollimi i objekteve të Kompanisë lidhur me gjendjen dhe mirëmbajtjen e tyre, kontrollimi i objekteve është realizuar të shërbimi operativ, rezervari shpatit, objekti të 40 burimet I dhe II, ku janë kontrolluar gjendja ekzistuese e objekteve.
- Gjatë periudhes së TM/3 janë bërë vazhdimisht kontrollimi i objektit dhe hapsires te “Filtrat” janë vërtur se rrethojat janë të demtuar në tërësi dhe për këtë gjendje të objektit janë njoftuar me shkrim përgjegjesit e kompanisë.
- Gjatë vizites te objekti i “Kuaguloret” kemi vërtur se është e demtuar një dritare (gjami i thyer) qe një kohë të gjatë, gjatë vizites është vërtur se pastertia në objekët dhe mirëmbajtje e hapsires për rrethë është në gjendje të mire.
- Gjatë periudhes së tremujorit kemi bërë kontrollimii i aparateve kunder zjarrit, kontrollimi i gjendjes të hidranteve për objektin e “Hidroregjionit Jugor” në Prizren, (objekti i administrates). Aparatet të gjitha janë të servisuar dhe janë në gjendje të rregullët si dhe të sistemuar në vendin duhur.
- Kontrollimi i objekteve te Mulliri i Vjeter, pastertia e mirëmbajtjes së objekteve është në nivelin të mirë.

Raport rreth punës së zyrës së teknologjisë informative për korrik - shtator 2017

Përshkrimi hyrës;

Janë disa angazhime të përditshme që ekzekutohen konform detyrimeve të vendit të punës për operim dhe funksionimit optimal të sistemit në përgjithësi dhe të cilat nuk evidentohen çdo herë në raporte për shkak të përsëritjes.

Prandaj ky raport shtron kryesisht aktivitetet e përmbledhura duke veçuar ndonjë punë ekzekutuese që ka patur peshe dhe ndikim të veçantë.

Raporti

- - Asistencë profesionale për funksionimin normal dhe optimal te rrjetit kompjuterik në bazë dhe në njësi të kompanisë.
- - Nderhyrje në njësinë e Malishevës (print, server, vpn router, klient) : 25 herë.
- - Nderhyrje ne Komunen – Malisheve: 25 here
- - Ndërhyrje në njësinë e Therandës (print, server, vpn router, klient) : 45 herë.
- - Nderhyrje ne Komunen – Suhareke: 13 here.
- - Ndërhyrje në njësinë e Dragashit (print, server, vpn router, klientë): 29 herë.

- - Ndërhyrje në njesitë Shatërvan: 47 herë.
- - Ndërhyrje në njesitë Depo: 4 herë.
- - Ndërhyrje në njesinë Filtrat: 65 herë.
- - Ndërhyrje në Komunë - Prizren: 35 herë.
- - Ndërhyrje në Ueb Faqe 8 herë; Njoftime për konsumatore, gjithsejt 4, ngarkim i dokumenteve, gjithsejt 4.
- - Ndërhyrje në Bazë (print, server, vpn router, klientë, fotokopje) : 548 herë.
- - Përkujdesje për qasjen e Kompanisë në rrjetin e internetit.
- - Përkujdesje për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e punës së serverit qendror, programit NAVISION, serverave të Njësive, serverit të GIS sistemit dhe sigurisë së të dhënave.
- - Asistencë teknike për funksionimin normal të rrjetit telefonik lokal dhe fiks.
- - Planifikim i infrastrukturës së mëturjeshme në bazë të nevojave dhe kërkesave të Kompanisë.
- - Riparim harvderik dhe softverik të paisjeve kompjuterike, programeve aplikative operacionale që shfrytëzohen në Kompani.
- - Mbikqyrje rreth zbatimit të kontratave të furnizimeve dhe serviseve të paisjeve kompjuterike e paisjeve të ngjajshme teknike.
- - Përkujdesje për licencimin - vazhdimin e licencimit të programeve operative të kompanisë.
- - Përditësim i ueb faqes së Kompanisë.
- - Ndërrim i tonereve të fotokopjes së faturave „Xerox 4110“ dhe 5645.
- - Përkujdesje ditore në ruajtjen e shënimeve të serverëve. Serveri Database, GIS, DNS.
- - Përkujdesje për garancionet e paisjeve dhe dërgimin e paisjeve të amortizuara për asgjësim në Depo.
- - Përkujdesje në hapjen e përdoruesve të rinjë në Baze dhe Njesi.
- - Rregullim i telefonit dhe internetit tek zyrja e rojeve në baze.
- - Përkujdesje për shënimin dhe organizimin e furnizimit të paisjeve nga furnitori
- - Konfigurim i modemit të ri të postës në Depo.
- - Funksionalizim i Gis Serverit dhe instalim i programeve të kërkuara nga punetoret e GIS, (.net, postgresql etj.)
- - Janë rregulluar telefonat fiks në njësine e Malisheves dhe Suharekes.
- - Shtrirje e kanaleve dhe rregullim i infrastrukturës së rrjetit në zyrën e faturave, koridor dhe zyreve në katin përthënë.
- - Hapje e përdoruesve të rinjë në NAV dhe Billing.
- - Krijim i PPTP Serverit për kyqjen e përdoruesve nga larg.

KONKURSET: KORRIK-SHTATOR= 2017

1	Inkasant	Dragash	Rishpallur	04.07.2017
2	Punetor Fizik	Suharekë		11.07.2017
3	Mirëmbajtës elektroteknik	Prizren		16.08.2017
4	Udheheqës i mirëmbajtjes elektro-hidro-mekanik të stacioneve të pompimit	Prizren	Anuluar-05.09.2017	16.08.2017
5	Gjeodet - GIS	Prizren		23.08.2017
6	Punetor Fizik	Prizren		12.09.2017
7	Punetor Fizik	Malishevë		12.09.2017

RAPORT I AUDITORIT TË BRENDSHËM

Përmes këtij raporti, është bërë përmbledhja dhe prezentimi i punëve dhe aktiviteteve të auditorit të brendshëm, të cilat janë realizuar gjatë tremujorit të tretë të vitit, gjegjësisht raporti i punës për periudhën kohore korrik – shtator 2017.

Në pajtim me planin vjetor të punës, si dhe bazuar në kërkesat e komisionit të auditimit, gjatë kësaj periudhe tremujore janë realizuar disa auditime, sikurse janë:

- auditimi i procesit të shpenzimeve në Nj.Punuese në Suharekë dhe Malishevë,
- auditimi i procesit të pagave,
- auditimi i procesit të faturimit, inkasimit dhe kontrollës,
- auditimi i transportit – shfrytëzimit të automjeteve zyrtare në Njësinë e Prizrenit, si dhe
- auditimi i proceseve dhe aktiviteteve në Njësinë e Suharekës.

Pas përfundimit të auditimeve, në pajtim me procedurat e punës dhe standardet e auditimit të brendshëm është punuar në:

- përgatitjen e draftraporteve të auditimit,
- mbajtjen e takimeve përmblyëse me menaxhmentin – subjektet e audituara,
- diskutimin e të gjeturave dhe rekomandimeve, si dhe është bërë
- finalizimi i raporteve.

Bazuar në konstatimet dhe të gjeturat e auditimeve të këtij tremujori, është konstatuar se në përgjithësi menaxhimi i proceseve dhe zhvillimi i procedurave,

- janë kryer në pajtim me dispozitat ligjore dhe aktet tjera të brendshme,
- është treguar një performancë e mirë e shërbimeve, si dhe
- është konstatuar një funksionim i mirë i kontrollit të brendshëm.

Në disa procese janë konstatuar edhe mangësi, ku dhe është rekomanduar që ato të përmirësohen, andaj edhe pritet që të realizohen gjatë muajve në vazhdimangjitur (shih raportet)

(Në mënyrë detale, raportet në fjalë janë i bashkangjitur këtij raporti tremujor).

Gjithashtu gjatë kësaj periudhe tremujore, është vepruar në:

- rishikimin e adresimit të rekomandimeve të dhëna gjatë tremujorit të dytë të vitit 2017,
- angazhimi në ofrimin dhe përgatitjen e dokumentacionit, lidhur fazën e përkohshme të auditimit të pasqyrave financiare, nga ana e auditorëve të ZKA-së, si dhe vlen të theksohet se gjatë tremujori kam kam shfrytëzuar pushimin vjetor dy javor.

Adresimet e rekomandimeve të tremujorit praparak TM/2

Në mënyrë që të jipet një pasqyrë e adresimeve të rekomandimeve të tremujorit të dytë (TM2), në mënyrë kronologjike, janë prezentuar konstatimet, të gjeturat, konkluzionet, rekomandimet, komentet dhe adresimi i tyre.

- Auditimi i procesit lidhur me menaxhimin e procesit të raportimit
- Auditimi lidhur me menaxhimin e procesit për shqyrtimin e lëndëve gjyqësore
Auditimi lidhur me menaxhimin e procesit të prokurimit, si dhe
Auditimi i planit të biznesit periudha kohore janar – maj 2017.

1. Auditimi i procesit lidhur me menaxhimin e procesit të raportimit

Duke u bazuar në të dhënat e rishikuara dhe të testuara është konstatuar se menaxhimi i procesit të raportimit në KRU Hidroregjioni Jugor është i një niveli të duhur, ka një kontrollë të brendshme funksionale, si dhe është zhvilluar në pajtim me obligimet ligjore për raportim, të parapara me Ligjin për Ndërmarrjet Publike me nr. 03/L-087, ligji nr. 04/l-111 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/l-087 për ndërmarrjet publike si dhe Udhëzuesin për Raportimin e Kompanive të Licencuara, të lëshuar nga ZRRUK-u (ARRU), të datës tetor 2008.

E gjetura: Është konstatuar gjithashtu se në disa raste ky proces kishte disa mangësi, e që janë vonesat apo mosrespektimi në përpikëri i afateteve kohore të përcaktuara për raportim. Kjo është vërejtur pothuaj në të gjitha llojet e raportimeve, sikurse atyre për NJPMNP (plan biznesi) poashtu edhe atyre për ARRU. Poashtu janë vërejtur mangësi në përmbajtjen e raporteve, konkretisht në komentet dhe arsyetimet e kërkuara, si nga ana e udhëheqësve të njësisve poashtu edhe të menaxherëve të shërbimeve përkatëse.

Konkluzion: Edhe përkundër shqetësimeve të paraqitura të ZLR-së si dhe vërejtjeve të dhëna nga KE gjatë takimeve të menaxhmentit, lidhur me këtë çështje, megjithatë procesi i raportimit ka vazhduar të përcillet me defekte të tilla. Konsideroj se një dukuri, paraqet pengesë në efikasitetin e punës së ZLR-së dhe në përgjithësi në procesin e raportimit.

Rekomandim: Rekomandoj ZLR-në që të kërkoj nga KE, që menaxherët e departamenteve dhe udhëheqësit e njësisve, të zbatojnë në përpikëri Udhëzimin për Procedurat e Raportimit, me nr.prot.863, të datës 25.08.2011. Poashtu rekomandohet ZLR që të kërkoj nga menaxhmenti i kompanisë që të rishikoj dhe nëse e shih të arsyeshme të vërë në funksion modulën e përgatitur nga ZLR, lidhur me përgatitjen e Plan Biznesit, meqë konsideroj se një dokument i tillë do të kishte ndikim në unifikimin e mënyrës së planifikimit dhe raportimit.

Komentet e menaxhmentit: Rekomandimi pranohet. Janë njoftuar të gjithë menaxherët dhe udhëheqësit përgjegjës, me çrast edhe janë zotuar se do t'i përmbahen udhëzuesit për raportim. Nëse kjo vazhdon të përsëritet, sipas menaxhmentit do të mirren masa ndëshkuese ndaj tyre.

Rekomandimi është duke u implementuar. Nuk janë vërejtur vonesat të tilla për periudhën në fjalë, ka filluar implementimi i modulit të përgatitjes së planit të biznesit sipas Njësive. Megjithatë sipas ZLR-së ka vend për përmirësime në përmbajtjen e komenteve të parapara sipas raportimeve gjeqjës.

2. Auditimi lidhur me menaxhimin e procesit për shqyrtimin e lëndëve gjyqësore

Gjatë auditimit të kryer në zyrën ligjore, për periudhën kohore të rishikuar, është konstatuar se menaxhimi i aktiviteteve në përgjithësi dhe në veçanti procesi i shqyrtimit të lëndëve gjyqësore nga ana e zyrës ligjore është menaxhuar mirë.

Poashtu gjatë auditimit është konstatuar se menaxhimi i këtij procesi, karakterizohet më një funksionim të mirë të kontrollit të brendshëm.

Konstatim: Bazuar në të dhënat e testuara, duke filluar nga iniciimi, kompletimi i dokumentacionit dhe mënyrës së realizimit, konsideroj se në përgjithësi procesi ka qenë në nivel të kënaqshëm

E gjetura: Megjithatë, si pasojë e mungesës së një akti apo udhëzimi të brendshëm, ku do të bëhej me shkrim definimi dhe ndarja e qartë e detyrave dhe përgjegjësisve të zyrës ligjore dhe shërbimit me konsumatorë, është konstatuar se edhe pse në aspektin profesional konsideroj se gjithçka ka qenë në rregull, megjithatë në aspektin funksional, çështja e zhvillimit të procesit në disa etapa ka pasur edhe mangësitë e veta.

Konkluzion: Mos ndarja e duhur e përgjegjësive duke filluar nga procesi i përcaktimit të listës së konsumatorëve për tu proceduar, çështjes së përpilimit dhe monitorimit të kontratave apo marrëveshjeve me konsumatorë, çështjes së bashkëpunimit profesional dhe çështjes së raportimit mes dy shërbimeve, konsideroj se krijon hapësirë dhe mundësi për procedim joefikas si dhe një shërbim jo i mirë ndaj konsumatorëve.

Rekomandim: Rekomandohet menaxherja e departamentit të administratës që në bashkëpunim me zyren ligjore, si dhe me mbështetje të menaxhmentit të lartë të shqyrtojnë mundësinë që përmes një komisioni të bëjnë hartimin e një vendimi apo rregulloreje të brendshme, që do të përshkruante detyrat, përgjegjësitë dhe formën e organizimit të procesit.

Komentet e menaxhmentit: Rekomandimi pranohet. Edhe pse një rregullore e tillë ishte inicuar të bëhet që nga vitit 2015, megjithatë për shkaqe objektive (si rezultat i mungesës së Sekretares gjatë vitit 2016), kishte mbetur pa u përfunduar. Besojmë se në bazë të vendimit të KE, do të formohet komisioni për finalizimin e rregullores..

Rekomandimi është implementuar. Është përgatitur dhe është aprovuar “Rregullorja për iniciimin e procedurës përmbartimore të organi përmbartues” me nr.prot.01-26/01, datë 29.09.2017.

3. Auditimi lidhur me menaxhimin e procesit të prokurimit

Duke u bazuar në testimet dhe të gjeturat e auditimit, për periudhën e rishikuar, është konstatuar që procedurat e prokurimit, të zhvilluara gjatë periudhës janar – prill 2017, nga ana e zyrës së prokurimit, janë në pajtim me ligjin e prokurimit publik 04/l-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/l-237, ligjin nr. 05/l-068 dhe ligjin nr. 05/l-092, legjislacionin sekondar, dhe dispozitat tjera ligjore; është konstatuar funksionim i mirë i kontrollit të brendshëm. Si dhe është konstatuar se në përgjithësi procedurat lidhur me pranimin e mallrave, realizimin e shërbimeve si dhe procesimi i pagesave, janë zhvilluar në pajtim me Rregullën Financiare nr.01/2013/ të Ministrisë së Financave, lidhur me shpenzimin e parave publike.

Në bazë të gjendjes së konstatuar, nuk është identifikuar ndonjë mangësi apo e gjetur, që do të rezultonte me dhënien e ndonjë rekomandimi.

4. Auditimi i planit të biznesit periudha kohore janar – maj 2017

Në bazë të testeve të kryera të të dhënave të realizuara financiare dhe operative, gjatë periudhës kohore janar – maj 2017, është konstatuar një performancë e mirë, megjithatë duhet theksuar se përmbushja e caceve të planifikuara sipas Planit të Biznesit 2017-2019 të KRU Hidroregjioni Jugor SHA Prizren, nuk është e nivelit të dëshiruar.

E gjetura. Gjatë auditimit të plan biznesit 2017-2019, është vërejtur që përgatitja dhe aprovimi i Planit të Biznesit është kryer në pajtim me afatet kohore të parapara sipas legjislacionit në fuqi. Megjithatë, mangësi rreth përgatitjes së tij, e që fatkeqësisht ajo po përsëritet, është mënyra e planifikimit, që në vend se të bëhet duke u bazuar në planifikim mujor dhe detal, për shkak të mos menaxhimit të mirë kohës rreth përgatitjes së tij, menaxherët e shërbimeve gjegjëse, atë e kanë përgatitur mbi baza të përgjithshme vjetore.

Konkluzion: Përgatitja e Plan biznesit, duke u bazuar në të dhëna mujore, është më real sepse planifikohet por edhe në të njëjtën kohë është në gjendje të monitorohet sa më saktë performanca e kompanisë.

Rekomandim: Rekomandohet menaxhmenti i kompanisë që të ketë parasysh këtë mangësi dhe gjatë përgatitjes së Planit të biznesit 2018 – 2020, por edhe gjatë revidimit – ndryshimit të plan biznesit për vitin 2017, të kenë parasysh që planifikimi të bëhet në baza mujore.

Komentet e menaxhmentit: Rekomandimi pranohet dhe besohet se një qjë e tillë do të realizohet gjatë përgatitjes së Planit të Biznesit për periudhën 2018 – 2020.

Liqërisht, gjatë muajit tetor kërkohet të finalizohet plan biznesi i kompanisë, ku edhe pritet të realizohet rekomandimi i dhënë.

E gjetura: Bazuar në këto testime dhe krahasime, sikurse edhe është prezentuar në tabelën e mëposhtme, mund të vërehet se realizimi aktual sipas të gjithë treguesve është në nivel më të ultë me ata të planifikuar, si në raport me BPK poashtu edhe atë të BPRR.

Ndryshimi i tyre është me një shumë dhe përqindje të ndryshme, duke nisur nga ajo më e ulta për shembull te inkasimi që është 0.64% dhe atij më të lartë që është te faturimi në m³ me 14.88 % dhe investimet që është 83.84%. Gjithashtu ka edhe tejkalime, sikurse rasti i shpenzimeve për 2.60 %.

Konkluzion: Lidhur me mosrealizimin në tërësi të Planit të Biznesit për periudhën janar - maj 2017, sipas menaxherëve përkatës ekzistojnë arsye të konsiderojnë se qëndrojnë, devijimi nga caqet e planifikuara, tregon për një angazhim shtesë që duhet të ndërmerret, meqë paraqet rrezik në likuiditetin dhe afarizmin e kompanisë.

Rekomandim: Bazuar në trendin, parametrat dhe performancën e realizuar gjatë këtij pesë mujori, e sidomos duke marrë për bazë edhe rrezikun e rënies së inkasimit, që mund të ndodh pas muajit shtator, kur edhe përfundon procesi i fales së borxheve, rekomandoj menaxherët e departamenteve përkatëse që të tregohen sa më të kujdesshëm dhe efikas meqë janë përgjegjës për Pl.Biznes.

Poashtu rekomandoj të shfrytëzojnë mundësinë ligjore që gjatë këtij muaji të bëjnë revidimin e tij, veprim i cili është në pajtim me ligjin nr.04/L-111, neni 17, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike).

Në fund duhet theksuar, se edhe pse revidimi i PBK mund të ketë implikime në BPRR, megjithatë, reduktimi i disa parametrave mund të zbut rrezikun e mospërbushjes së Planit në nivelin e planifikuar. Konsideroj se nevojë imediate për revidim ka parametri i prodhimit, faturimit e sidomos ai i investimeve që konsideroj se është vështirë i arritshëm.

Komentet e menaxhmentit: Edhe përkundër mundësisë për revidim, ishte vendosur që të vazhdohet me të njëjtin plan, dhe presim që angazhimi të jetë maksimal në drejtim të realizimit të tij. Andaj mbetet të shihet gjatë procedimit dhe hartimit të plan biznesit 2018-2020.

VI. AKTIVITETET E PROKURIMIT- PËR VITIN FISKAL 2017

Nr.	Vetanake /Donacion	Titulli I Aktivitetit te Prokuimit	Nr.i Prokurimit	Data e nenshkrimtit	Vlera e kontrates	O.E	Vrejtje	Data e skadimit.
1		Hulumtimi i knaqmerise se konsumatoreve per periudhen janar-dhjetor 2016 ne zonen e sherbimit te cilen e mbulon KRU "Hidroregjioni Jugor" sh.a	HJ/17/001/136	01.03.2017	1,839.00€	D&D Business Suport Center		
2		Ritender:Furnizim me paisje te teknologjise per komunikim dhe pune per Shukos	HJ/17/002/136	03.03.2017	8,899.00€	"Meriton Tershnjaku"B.I		
3		Furnizim me material elektrik	HJ/17/003/121				Anuluar :28.04.2017	
4		Lot I:Material Laboratorik Lot II:Pjese dhe paisje laboratorike	HJ/17/004/121	08.05.2017	39,414.00€	N.P.T "Eramed"	Lot II:Anuluar	04.05.2020
5		Vinklimi I elektromotoreve	HJ/17/005/221	08.05.2017	58,970.00€	D.P.T "Elektron		04.05.2020
6		Furnizimi dhe mirmbajtja e aparateve kunder zjarrit tek objektet ,stacionet pompuese trafot e tensionit te larte dhe automjeteve	HJ/17/006/136	02.05.2017	2,885.00€	SAP International		02.05.2020
7		Furnizim me zalle	HJ/17/007/121	15.05.2017	22,958.20€	SHPK "Eurovia"		14.05.2020
8		Furnizim me paisje dhe mjete pune	HJ/17/008/121	19.05.2017	17,200.00€	Npt "Moni"		Skadon ne afat prej 30 dite
9		Furnizim me GPS	HJ/17/009/121					Eshte anuluar
10		Furnizim me klor	HJ/17/010/121	29.05.2017	53,040.00€	SHPK "Seykos"		28.05.2017

11		Mirmbajtja,perkraha dhe funksionimi I sistemit informative I kompanise	HJ/17/011/221					Anuluar 23.06.2017
12		Furnizim me autovetura Transporti ted ores se dyte	HJ/17/012/121	16.06.2017	21,580.20€	Artius Group shpk		03.07.2017 Pranimi Teknik
13		Ritender:Furnizim me material elektrik	HJ/17/003/121	17.07.2017	86,502.60€	NP "Kastel-ing"		16.07.2019
13		Furnizim me pjese te IT	HJ/17/013/121	25.07.2017	43,460.50€	Europrinty		23.07.2020
14		Retender:Furnizim me GPS	HJ/17/009/121					Eshte anuluar me dt.28.07.2017 ne mungese te ofertuesve
15		Furnizim me inventar per zyre	HJ/17/014/121	31.08.2017	13,945.00€	SHPK "Gold Invest"		30.08.2020
16		Pjese dhe paisje per dezinfikim	HJ/17/015/136	18.08.2017	9,169.83€	Ntp "Avesta"		15dite nga parashtrimi I kerkeses nga AK
17		Furnizim me pjese per Toyoten	HJ/17/016/136	04.09.2017	1,893.00€	NTP "Besi"		10 dite nga parashtrimi I kerkeses se AK-se
18		Hapja e Puseve	HJ/17/017/521					Hapja do te behet me 30.10.2017
19		Servesimi I Automjeteve	HJ/17/018/221					Eshte anuluar ne mungese te OE te pergjegjshem me dt.24.10.2017
20		Furnizim me Karburant	HJ/17/019/121					Kontrata do te nenshkruhet me dt.27.10.2017
21		Furnizim me lend djegese Dru dhe Pelet	HJ/17/020/136	13.10.2017	2,385.12€	NTSH "Tini"		5dite nga parashtrimi I kerkeses nga AK
22		Rehabilitimi I sisitemit te ujesjellesit ne fshatrat (zonat rurale) ne komunen e Suharekes (pune shtese)	HJ/17/021/536					Hapja do te behet me 30.10.2017

23		Retender II:Furnizim me GPS	HJ/17/009/121					Hapja do te behet me 31.10.2017
24		Ndertimi I zyres –Arke per kryerjen e pagesave te faturave te ujite ne lagjen “Bajram Curri”	HJ/17/022/536					Hapja do te behet me 13.11.2017
25		Sherbim:Mirmbajtja ,perkraha dhe funksionimi I sistemit informative te kompanise	HJ/17/023/231					Hapja do te behet me 10.11.2017
26		Ndertimi I Kaptazhes ne fshatin Dobrushte-Prizren	HJ/17/024/536					Hapja do te behet me 07.11.2017
27	ANEX KONTRATA	Ritenderim-Rehabilitimi I sistemit te ujesjellesave ne zonat rurale –faza e V-te per Suhareke,Malisheve dhe Prizren LOT III-Fshatrat e Malisheves	HJ/16/009/511	17.07.2017	7,878.89€	“Muratori”		
28	ANEX KONTRATA	LOT II Fshatrat e Suharekes: Rehabilitimi I sistemit te ujesjellesave ne zonat rurale – faza e V-te per Suhareke,Malisheve dhe Prizren	HJ/16/009/511	17.07.2017	10,261.63€	NN”Infra Plus”		
29	ANEX KONTRATA	LOT VII:Kompezatoret e energjise reaktive Rehabilitimi I sistemit te ujesjellesave ne zonat rurale – faza e V-te per Suhareke,Malisheve dhe Prizren	HJ/16/009/511	17.07.2017	1,696.00€	SHPK “Drini AB”		
30	ANEX KONTRATA	Marrveshje per ndryshime dhe pune shtese per tenderin:Rehabilitimi I Kaptazhes ne fshatin Gjonaj	HJ/016/020/521	21.07.2017	3,555.50€	Albing shpk-NNSH Burimi		

STRUKTURA ORGANIZATIVE
KRU „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A. PRIZREN

